VENDIM
Nr. 345, datë 21.12.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 171, DATË 16.8.2021, "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR 'ALBGAZ' SHA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2094/3 prot., datë 19.12.2022, të drejtorive teknike të ERE-s, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, "Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, 'Albgaz' sh.a.", të ndryshuar",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 171, datë 16.8.2022, ka vendosur:

1. Të miratojë Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, "Albgaz" sh.a., me kushtin që shoqëria, brenda 3 muajve ta depozitojë atë në ERE të përditësuar me përcaktimet, sipas kërkesave të pikës 5, pikës 6 dhe pikës 15, të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017.

2. Mosplotësimi i kushtit, sipas përcaktimeve të pikës 1, përbën shkak për rishikimin e këtij vendimi.

- Në vijim dhe bazuar te kërkesa e vetë shoqërisë "Albgaz" sh.a., Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 236, datë 26.11.202, vendosi:

Të zgjasë me 3 (tre) muaj, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, afatin e përcaktuar në pikën 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, "Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, 'Albgaz' sh.a."

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme nëpërmjet shkresës nr. 53/9 prot., datë 2.11.2021, dhe nëpërmjet shkresës nr. 226 prot., datë 7.2.2022, i rikujtoi detyrimin për të plotësuar sa kërkohet brenda afateve të përcaktuara në vendim, pra brenda datës 26.2.2022.

- Shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 324 prot., datë 28.2.2022, është shprehur, se ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për të shtyrë afatin e plotësimit të kushteve të përcaktuara pikën 1 të vendimit nr. 171/2021, të ndryshuar.

- Në vijim, bazuar të diskutimet e zhvilluara në seancën dëgjimore të datës 11.4.2022, ora 11:00, pranë ambienteve të Entit Rregullator të Energjisë, korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë "Albgaz" sh.a. dhe shqyrtimit të Programit të Përputhshmërisë në tërësi, vlerësohet që t'i lihet detyrë shoqërisë "Albgaz" sh.a. që të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për sa i përket:

a) marrëdhënieve të aksionarëve të shoqërisë "Albgaz" sh.a. me kompani të angazhuara me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror dhe energji elektrike ose ato që kanë ndonjë interes komercial (pika 5 e Programit të Përputhshmërisë së "Albgaz" sh.a.);

b) ndarjes dhe pavarësisë së organeve publike, të cilat janë të autorizuara të përfaqësojnë të drejtat e aksioneve shtetërore nga njëra anë dhe kompanive të angazhuara me prodhimin dhe furnizimin nga ana tjetër (pika 6 e Programit të Përputhshmërisë së "Albgaz" sh.a.).

- Po ashtu, nga shqyrtimi në tërësi i Programit rezulton se janë pasqyruar drejtuesit e OST-së, sipas funksioneve që mbajnë, duke plotësuar kështu kërkesat e pikës 15 të Programit tip të Përputhshmërisë, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77/2017.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti administrativ, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

"1. Të miratojë Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, 'Albgaz' sh.a.".

2. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

"2. Shoqëria 'Albgaz' sh.a. duhet të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për sa u përket:

a) marrëdhënieve të aksionarëve të shoqërisë 'Albgaz' sh.a. me kompani të angazhuara me prodhimin dhe/ose furnizimin me gaz natyror dhe energji elektrike, ose ato që kanë ndonjë interes komercial (pika 5 e Programit të Përputhshmërisë së 'Albgaz' sh.a.);

b) ndarjes dhe pavarësisë së organeve publike, të cilat janë të autorizuara të përfaqësojnë të drejtat e aksioneve shtetërore nga njëra anë dhe kompanive të angazhuara me prodhimin dhe furnizimin nga ana tjetër (pika 6 e Programit të Përputhshmërisë së 'Albgaz' sh.a.).".

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë shoqërinë dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti